

VENDIM
Nr. 94, datë 4.2.2015

PËR PROCEDURAT PËR ARMËT, NË RASTET E DEKLARIMIT TË VDEKJES,
DEKLARIMIT TË MBYLLJES LIGJORE TË AKTIVITETIT, PËR QËLLIME
STUDIMORE, TË HUMBJES SË ARMËS, VJEDHJES SË SAJ APO
DOKUMENTIT/AUTORIZIMIT
(ndryshuar me VKM nr. 269, datë 12.5.2021)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 44, të ligjit nr. 74/2014, datë 10.7.2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPONIMI I ARMËS ME VDEKJEN E PRONARIT TË SAJ

1. Në rast vdekjeje të pronarit të armës, një pjesëtar madhor i familjes së tij ose përfaqësuesi i tij ligjor, kujdestari i të miturit apo personit që i është bequr zotësia apo ka zotësi të kufizuar, personi që ka jetuar me të në të njëjtën banesë ose personi tek i cili gjendej arma në momentin e vdekjes, si edhe çdo person që ka dijeni për ekzistencën e një arme në pronësi të personit të vdekur është i detyruar që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të njoftojë online në Portalin Unik Qeveritar e-Albania ose strukturën vendore të policisë ku janë regjistruar armët, nëse dihet, ose strukturën e policisë ku ka vendbanimin personi që ka humbur jetën.

2. Armët, pjesët përbërëse të tyre, tërhiqen nga punonjësi i policisë së njesisë ku janë regjistruar dhe merren në ruajtje, në pritje të trashëgimitarit për t’i marrë e regjistruar në pronësi. Në momentin e dorëzimit të tyre organi përgjegjës për armën dhe municionin e dorëzuar pajis dorëzuesin me një vërtetim.

3. Trashëgimtari i vetëm i armës, pjesëve përbërëse të saj, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga momenti i pranimit të trashëgimisë apo i përfundimit të afateve për heqjen dorë nga trashëgimia, si dhe kujdestari ligjor i trashëgimitarit, të cilit i është bequr apo kufizuar zotësia për të vepruar, me vendim gjyqësor detyrohet të kryejë një nga veprimet e mëposhtme:

- a) të tjetërsojë armën, pjesët përbërëse të saj dhe municionin; ose
- b) të paraqesë kërkesë për pajisjen me autorizim për “mbajtje arme”; ose
- c) të dorëzojë armën për ta çaktivizuar; ose
- ç) t’ia dorëzojë armën, pjesët përbërëse të saj dhe municionin, Drejtorisë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin, pa asnjë kundërshtim.

3.1 Në rast se trashëgimtari i armës dhe municionit është i mitur, arma, pjesët e tyre dhe municioni do të qëndrojnë në ruajtje pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit deri sa i mituri të arrijë moshën për t’u pajisur me autorizim për armë. Trashëgimtari i armës, me arritjen e moshës 25 vjeç, është i detyruar që të veprojë sipas përcaktimeve në pikën 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të këtij vendimi.

3.2 Kur trashëgimtari i armës e tjetërson atë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shitjes, detyrohet ta çregjistrojë armën në fjalë nga regjistri i armëve, pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.

3.3 Kur trashëgimtari i armës paraqet kërkesë për pajisjen me autorizim “mbajtje arme”, organi përgjegjës i Policisë së Shtetit e pajis me autorizimin përkatës nëse përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar.

3.4 Nëse trashëgimtari i armës dëshiron ta mbajë atë si relike, duhet ta çaktivizojë atë në mënyrë të përbërshme dhe, brenda 5 (pesë) ditëve, ta çregjistrojë pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit. Shpenzimet e çaktivizimit të armës mbulohen nga kërkuesi.

3.5 Arma, që trashëgimtari i dorëzon Drejtorisë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin, pa asnjë kundërshtim, çregjistrohet nga regjistri i armëve pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.

4. Nëse kalojnë 6 (gjashtë) muaj nga vdekja e personit, pronar të armës, dhe trashëgimtarët nuk kanë vendosur për destinacionin e armës, struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit i dërgon titullin

ekzekutiv të revokimit të autorizimit të mbajtjes së armës strukturës së përmbarimit të ekzekutimit të vendimit, e cila realizon tjetërsimin e armës, nëpërmjet procedurave të ankandit publik.

II. DISPONIMI PËR ARMËT PAS MBYLLJES SË AKTIVITETIT

5. Subjekti, me mbylljen ligjore të aktivitetit, bën njoftimin online për strukturën e Policisë së Shtetit, e cila me marrjen dijeni nga subjekti dhe në prezencë të tij bën menjëherë, por jo më vonë se 24 orë nga marrja dijeni, bllokimin e armëve të lejuara, së bashku me municionet e tyre, kundrejt procesverbalit përkatës, ku një kopje e tij i jepet të interesuarit.

6. Komisioni i dhënies së licencës, në rastin e mbylljes ligjore të aktivitetit për veprimtaritë e lejuara me armë, me vendim, bën heqjen e licencës.

7. Në bazë të vendimit të komisionit qendror për heqjen e licencës, komisariati i policisë ka të drejtë t'i japë subjektit një afat, deri në 6 (gjashtë) muaj, për tjetërsimin e armëve, sipas ligjit në fuqi për armët.

8. Me mbarimin e këtij afati, struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit i dërgon titullin ekzekutiv të revokimit të autorizimit të mbajtjes së armës strukturës së përmbarimit të ekzekutimit të vendimit, e cila realizon tjetërsimin e armës, nëpërmjet procedurave të ankandit publik.

9. Rregullat e caktuara më sipër kanë të njëjtën vlerë edhe në rastin kur subjektit i hiqet licenca për shkelje të ligjit, nga komisioni përkatës.

III. DISPONIMI PËR ARMËT PËR QËLLIME STUDIMORE

10. Armët dhe municionet e sekuestruara e të konfiskuara si provë materiale, pas mbarimit të gjykimit, me vendim të formës së prerë të gjykatës, mund të merren në administrim, për qëllime studimore, nga policia shkencore, pas miratimit nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

11. Armët, pjesët dhe municioni i tyre, të marra për qëllime studimore, nuk lejohet të përdoren jashtë këtij qëllimi. Në armët, objekt studimi shkencor, nuk lejohet të bëhen ndryshime, shënime, zëvendësime e modifikime të pjesëve të tyre.

12. Armët, pjesët e tyre dhe municionet, të marra për qëllime studimi, pas përfundimit të studimit dorëzohen në magazinat qendrore të Policisë së Shtetit.

13. Kur armët kërkohen të mbahen në Policinë Shkencore, si ekzemplarë, përgjithmonë, më parë duhet të paaftësohen. Miratimi për sasinë, llojin dhe kalibrin e armëve, për t'i paaftësuar, bëhet nga ministri i Punëve të Brendshme. Armët e paaftësuara vulosen me inicialin "LB".

IV. PROCEDURA E ARMËVE TË DEKLARUARA TË HUMBURA, TË VJEDHURA

14. Personi fizik e juridik, në rast të humbjes apo vjedhjes së armës, pjesëve të saj apo municionit, duhet të njoftojë, në afatin brenda 24 orëve nga momenti i konstatimit, në komisariatit e policisë ku ka ndodhur ngjarja dhe atje ku arma është e regjistruar *ose online në Portalin Unik Qeveritar e-Albania*.

15. Komisariati i policisë, për armën e humbur apo të vjedhur, adreson kallëzimin për ngjarjen në prokurori, për hetimin e rrethanave.

16. Komisioni vendor, në rastet e humbjes apo vjedhjes së armës, shqyrton rrethanat dhe merr vendim për revokimin e autorizimit për mbajtje të armës. Për pronësinë e armës veprohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", dhe këtij vendimi.

17. Në rast të humbjes apo vjedhjes së autorizimit për blerje/mbajtje armë zjarri apo autorizimit si koleksionist, dhe çdo autorizimi tjetër, qoftë ai i përkohshëm, personi fizik a juridik njofton komisariatit e policisë ku ka ndodhur ngjarja *ose online në Portalin Unik Qeveritar e-Albania*.

18. Pas kryerjes së procedurës së kallëzimit, arma e zjarrit, e humbur apo e vjedhur, hiqet nga regjistri i armëve dhe regjistrohet në armët e humbura.

19. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama